

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga raporti i Dick Martyt deri te Haga, si u krijua Gjykata Speciale?
ADRESA	https://www.koha.net/arberi/nga-raporti-i-dick-martyt-deri-te-haga-si-u-krijua-gjykata-speciale
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 01:37:35 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 17:23:17 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c374caa3a052faaf9f7b075d635cbd141799e2d6e48090b45c3837dd30797075
TEKSTI	3c6bf2e79155263f145016e6dff8d63a84296ca9e1ff105d923c74747b24319a
PAMJA	c062c964515f7dfcd712b91ab202faab77b40b1a2d3a388d606f036b21a2a585

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0b3f067669361507a3e11b3685f60fe778a70843611b2e7d14d43d4a4e8ccad8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	339a441950953cdd8a76a2c095ab2238d5bab62fcc252abcef1242a6a5fba2fb
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0b3f067669361507a3e11b3685f60fe778a70843611b2e7d14d43d4a4e8ccad8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën

Kontribuo →

Letër lexuesit

ARBËRI

Nga raporti i Dick Martyt deri te Haga, si u krijua Gjykata Speciale?



Nga: Blendina Veliqi

14 shtator 2026 19:23

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalën tonë zyrtar në Viber

Krijimi i Dhomave të Specializuara të Kosovës u bë pas pretendimeve të ngritura në raportin e senatorit zviceran, Dick Marty, sipas të cilit pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës akuzoheshin për përfshirje në krime të rënda, përfshirë edhe pretendimet për trafikim organesh. Pretendimi për trafikim organesh nuk u provua, por çështja tashmë ishte ndërkombëtarizuar. Pas hetimeve të mëtejshme, Kosova mori përsipër themelimin e një mekanizmi të veçantë gjyqësor për trajtimin e akuzave që dolën nga këto hetime

Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë, të cilat në kuadër të drejtësisë tranzicionale njihen edhe si një gjykatë hibride, janë perceptuar nga një pjesë e opinionit publik si të njëanshme sa i përket trajtimit të proceseve gjyqësore.

Krijimit të kësaj gjykate i kanë paraprirë pretendimet e ish-prokurores së Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, Carla Del Ponte. Ajo pretendonte se pjesëtarë të UÇK-së ishin përfshirë në ndalimin e personave, disa prej të cilëve, sipas saj, ishin dërguar në Shqipëri, ku dyshohej se u ishin hequr organet.

Për të verifikuar këto pretendime, në vitin 2008, Këshilli i Evropës caktoi senatorin zviceran, Dick Marty.

Raporti i Dick Martyt u prezantua në dhjetor të vitit 2010 para Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

Në të u kritikuan edhe ndërkombëtarët që kishin administruar Kosovën pas vitit 1999, me pretendimin se kishin neglizhuar hetimin e këtyre rasteve dhe se krimet kishin mbetur të pandëshkuara.

Edhe



Arbëri • 19 pri 2026

Surroi për Gjykatën Speciale: Rast unikal,

Arbëri.

Mustafa: Jam takuar me Kurtin për ta diskutuar platformën time për zhblokimin institucional

Futboll.

Newcastle pëson debakël nga Leeds

Futboll.

Spektakël në Serie A, Interi fiton 5:3 ndaj Udineses

Futboll.

Kosova i luan 4 ndeshje brenda 16 ditësh grumbullim

Arbëri.

VV-ja pas tërheqjes së Sejdiut: Ishte mundësia që çështja e presidentit të zgjidhej, por u bllokua sërish

LAJMET E MBRËMJES.

Mbrojtja kërkon lirim të Thaçit e katër të tjerëve në rastin për pengim të drejtësisë



u bë presion nga pushteti për formimin e saj

Kjo më vonë ishte evidentuar edhe në draftrezolutën e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, në të cilën thuhej se është e nevojshme që të hartohet një instrument ligjor ndërkombëtar për të ndjekur penalisht autorët e këtyre krimeve.

Në linjë të kësaj, në fillim të 2011-s u krijua Task Force Special Investigative e BE-së, e cila kishte për qëllim hetimin e këtyre pretendimeve, në krye të secilës ishte prokurori amerikan, Clint Williamsoni, i cili më herët kishte punuar edhe në Tribunalin Penal për Ish-Jugosllavinë.

Pas afër tre vjetësh punë në këtë task-forcë, Williamson prezantoi gjetjet duke theksuar se kanë arritur të sigurojnë prova të mjaftueshme për të ngritur aktakuzë kundër disa zyrtarëve të lartë të UÇK-së.

“Elemente të caktuara të UÇK-së qëllimisht i vunë popullsitë pakicë në shënjestër me veprat e persekutimit që përfshinin vrasje të paligjshme, rrëmbime, zhdukje të detyruara, burgime të paligjshme në kampe në Kosovë dhe në Shqipëri, dhunë seksuale, forma të tjera të trajtimit çnjerëzor, zhvendosje me dhunë të individëve nga shtëpitë dhe komunitetet e tyre si dhe përdhosjen dhe shkatërrimin e kishave dhe vendeve të tjera fetare”, pati thënë ai.

Kjo task-forcë, e cila ishte krijuar pas pretendimeve për trafikim organesh, nuk gjeti prova për të ngritur një akuzë të tillë.

Përpara një deklarate të tillë të Williamson, ish-ambasadorja amerikane në Kosovë, Tracey Ann Jacobson, kishte dhënë disa informacione, duke shtuar se si do të dukej gjykata që do të trajtonte këto akuza e cila sipas saj, do të largonte renë e zezë nga vendi.

“Duke krijuar një gjykatë speciale, një gjykatë të veçantë të Kosovës, e cila do të përbëhej nga gjyqtarë ndërkombëtarë me seli në Kosovë, por edhe me një seli jashtë saj. Ku mund të trajtoheshin çështje të ndjeshme, si intervistimi i dëshmitarëve. Kosova do të tregonte se është e gatshme që të marrë përgjegjësinë e saj ndërkombëtare dhe në këtë mënyrë do të forconte kredibilitetin e saj”, pati thënë Jacobson.

Por, Ann Jacobson kishte thënë se sfida në krijimin e kësaj gjykate ishte votimi i tri të katërtave të Kuvendit të Kosovës.

Ndërsa në letrat që shkëmbyen presidentja e atëhershme e Kosovës, Atifete Jahjaga, me përfaqësuesen e lartë të BE-së për Punë të Jashtme, Catherine Ashton, thuhej se “nëse hetimi i Task-Forcës Speciale Hetimore çon në një aktakuzë dhe në një gjykim, duhet të krijohet një mjedis i përshtatshëm për administrimin e duhur të drejtësisë”.

Rrjedhimisht ishte thënë se për këtë çështje do të duhej që të përdorej një tribunal i specializuar me bazë në Kosovë, por që procedurat do të zhvilloheshin jashtë duke pasur parasysh natyrën e akuzave.

Krijimin e kësaj gjykate do ta shtynte kriza politike që kishte karakterizuar vendin pas zgjedhjeve të qershorit 2014.

Presioni ndërkombëtar

Përfaqësues amerikanë dhe evropianë u patën vënë në lëvizje diplomatike për të bindur autoritetet e Kosovës që të miratojnë themelimin e një Tribunali ose Gjykate Speciale për të hetuar dhe gjykuar rastet e dyshuara për krime lufte.

Në qershor të 2015-s sërisht ishte ambasadorja Jacobson që bënte thirrje për formimin e Speciales duke thënë se të gjithë e dinë se cila do të ishte alternativa. Ajo kishte shtuar se SHBA-ja dhe vendet e tjera strategjike nuk do të bllokoni procesin e Kombeve të Bashkuara.

“U bëj thirrje liderëve politikë të Qeverisë dhe Parlamentit që të marrin këtë çështje seriozisht dhe të ecin përpara pa rrezikuar legjitimitetin dhe reputacionin e vazhdueshëm të Kosovës për hir të një numri të vogël individësh që mund të akuzohen nga kjo gjykatë”, pati thënë ajo.

Deputetët dhe subjektet politike fillimisht e kishin kundërshtuar themelimin e kësaj gjykate, por më vonë ata zbutën qëndrimet e tyre.

Zbutja e terminologjisë nga fjala Tribunal në Gjykatë Speciale, sadopak i pati relaksuar qëndrimet e partive parlamentare.

Përpjekja e parë për votimin e marrëveshjes mes Kosovës e BE-së për themelimin e Speciales dështoi më 26 qershor 2015.

Por, pas pak javësh, më 3 gusht 2015, përfaqësuesit e PDK-së, LDK-së, Listës Serbe, Grupit parlamentar 6+ e disa deputetëve pa grup parlamentar votuan për themelimin e saj.

Edhe



Arbëri • 16 tet 2025

Berisha: E turpshme të mendohet se Thaçi e pranoi Specialet për t'i dërguar shokët e tij

Nga 117 deputetë të pranishëm, votuan 88. Prej tyre, 82 ishin për, pesë ishin kundër dhe një prej tyre abstenoj.

Gjatë fjalimit të tij para Kuvendit, lideri i asaj kohe i PDK-së, Hashim Thaçi, pati thënë se kërkesa e bashkësisë ndërkombëtare ndaj Kosovës për themelimin e Gjykatës për krime lufte është padrejtësia dhe fyerja më e madhe që i bëhet Kosovës.

Sidoqoftë, Thaçi pati përsëritur qëndrimin e tij të shprehur, se pavarësisht kësaj padrejtësie, siç e kishte quajtur ai, institucionet e Kosovës duhet të themelojnë këtë gjykatë.

Kundër saj ishte pozicionuar vetëm Lëvizja Vetëvendosje. Lideri i Vetëvendosjes, Albin Kurti, pati thënë se Kuvendi nuk do të duhej të miratonte themelimin e kësaj Gjykate, dhe ishte shprehur i bindur se as Këshilli i Sigurimit nuk do ta themelonte atë.

Në atë seancë, Partia Demokratike e Kosovës pati dalë edhe me propozimin që Kuvendi të marrë vendim për themelimin e një fondi, përmes të cilit, Qeveria e Kosovës me buxhetin e shtetit t'i mbulonte të gjitha shpenzimet e pjesëtarëve të UÇK-së gjatë proceseve gjyqësore që do të ngrihen ndaj tyre nga gjykata e veçantë.

Në janar të vitit 2016, u miratua Marrëveshja e Përkohshme midis vendeve të ulëta dhe Kosovës në lidhje me vendosjen e Institucionit Gjyqësor të Specializuar të Kosovës në Holandë. Kurse, në shkurt të vitit 2016, u miratua marrëveshja me shtetin pritës – Holandën.

Më 17 mars 2017, u votua edhe Rregullorja e Procedurave dhe provave të kësaj Gjykate. Ato u rishikuan më 29 maj 2017 dhe pasi u vlerësuan në përputhje me Kushtetutën, kanë hyrë në fuqi më 5 korrik të po atij viti.

Nisma për zhbërjen e Speciales

Më 22 dhjetor 2017, me nismë të deputetëve të partive të atëhershme në pushtet: PDK, AAK dhe Nisma, u tentua të bëhej shfuqizimi i Speciales, por reagimi i bashkësisë ndërkombëtare ishte i ashpër. Kërcënoi me pasojë të mëdha për Kosovën. Nisma nuk u hodh në votim Shtetet e Quintit patën shprehur shqetësimin e thellë me përpjekjet në Kuvendin e Kosovës për shfuqizimin e Gjykatës Speciale për krime lufte, përkatësisht Dhomave të Specializuara.

“Jemi thellësisht të shqetësuar me përpjekjet e vazhdueshme për të zhvlerësuar punën e Dhomave të Specializuara”, thuhej në deklaratën e përbashkët.

Me Kushtetutë, DHSK-ja kishte mandatin për pesë vjet, por më pas ishin bërë ndryshimet asisoj që ky mandat do të vazhdonte derisa Këshilli i Bashkimit Evropian do të njoftonte për përfundimin e mandatit.

Aktivitetet e para të kësaj gjykate kishin filluar qysh në fund të 2018-s, kur Rrustem Mustafës, ish-komandant i Zonës Operative të Llapit, i ishte dërguar ftesa që të intervistohet më fillim të 2019-s.

Etoat ishin pranuar më pas edhe nga ish-njësitë të tiorë të

Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

I arrestuari i parë nga Specialja ishte Salih Mustafa i njohur me nofkën Cali, aktakuza ndaj të cilit ishte konfirmuar më 12 qershor 2020, ndërsa në shtator të po të njëjtit vit ishte transferuar në Qendrën e Paraburgimit në Hagë.

Ai akuzohej për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, i cili më vonë u dënua me burgim dhe me urdhër për dëmshpërblimin e viktimave në vlerë të 207 mijë eurove.

Shtatori i 2020-s shënon edhe arrestimin e Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt nën dyshimin për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë. Ata më vonë u dënuan.

Aktakuza kundër katër ish-drejtuesve të UÇK-së u konfirmuan më 26 tetor 2020 nga Dhomat e Specializuara.

Më 5 nëntor të atij viti, pasi dha dorëheqje nga posti i presidentit, Thaçi u arrestua nga policia ndërkombëtare.

Në një konferencë për media në Prishtinë, Thaçi tha se ky është një çmim i radhës për lirinë.

Aktakuza e Speciales ndaj Hashim Thaçit, së bashku me atë ndaj Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, u konfirmua nga gjyqtari i procedurës paraprake më 26 tetor 2020.

Specialja e arsyetoi paraburgimin e tij dhe të tjerëve me mundësinë e frikësimit e rrezikimit të dëshmitarëve.

E në mars të 2021-s u arrestua në Belgjikë edhe Pjetër Shala nën akuzat për krime lufte, ndaj të cilit Apeli ka vendosur burgim prej 13 vjetësh si dhe dëmshpërblim ndaj viktimave në vlerë të 208 mijë eurove.

Për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë janë dënuar edhe Haxhi Shala, Sabit Januzi dhe Ismet Bahtijari.

Edhe

Arbëri • 6 o. më parë

Rutte: KFOR-i është aty, pavarësisht ç'mund të ndodhë këtë javë në Kosovë

Ndërsa, për vepra të ngjashme janë duke u gjykuar Hashim Thaçi, Bashim Smakaj, Isni Kilaj, Fadil Fazliu dhe Hajredin Kuçi.

Kundër kësaj gjykate dhe në përkrahje të personave që janë akuzuar nga Specialja, në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Hagë, Kroaci e Strasbourg të Francës janë organizuar disa protesta.

#GJYKATA SPECIALE

#DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS

Artikuj të ngjashëm

Arbëri • 12 sht 2026

Kush duhet t'i kompensojë viktimat dhe ata që shpallen të pafajshëm në Speciale?

Arbëri • 10 sht 2026

Thaçi për Gjykatën Speciale: E shmangëm Rusinë, sot po e paguaj çmimin me lëkurën time



Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografisë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë original apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësisë që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing

Politika e privatësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzim për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.